



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 227

Tiranë – E mërkurë, 23 nëntor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 117/2016 datë 10.11.2016	Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Modernizimi i asistencës sociale”, të ratifikuar me ligjin nr. 84/2012..... 23813
Ligj nr. 118/2016 datë 10.11.2016	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor..... 23816
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 776, datë 2.11.2016	Për shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Bënjë dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth.. 23824



LIGJ
Nr. 117/2016

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT
TË MARRËVESHJES SË HUAS
NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT “MODERNIZIMI I
ASISTENCËS SOCIALE”, TË
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 84/2012**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi i marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Modernizimi i asistencës sociale”, të ratifikuar me ligjin nr. 84/2012, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 10.11.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9854, datë 17.11.2016,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Banka Botërore

**BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM SHOQATA
PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR**

1818 H Street N.W
Washington D.C. 20433
U.S.A

(202) 473-1000

Adresa kablllore: INTBAFRAD

Adresa kablllore: INDEVAS

_____, 2016

Sh.T. Arben Ahmetaj
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Dëshmorët e Kombit
Nr. 4, Tiranë
Republika e Shqipërisë

**Lënda: Republika e Shqipërisë: Projekti
për Modernizimin e Asistencës Sociale
(Numri i huas 8141-AL)**

AMENDIM
PËR MARRËVESHJEN E HUAS

Shkëlqesi,

I referohemi Marrëveshjes së Huas (Marrëveshja), të datës 6 qershor 2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), për projektin e sipërpërmendur. Në përgjigje të letrës suaj për Bankën Botërore, të datës 6 prill 2016, Banka Botërore propozon të amandohet Marrëveshja si më poshtë:

1. Tabela në seksionin IV.A.2 e skedulit 2 (Tërheqja e kësteve të huas) e Marrëveshjes amandohet si më poshtë:

Kategoria	Shuma e huas (e shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar (duke përfshirë taksat)
1. Pagesat për programin e shpenzimeve të pranueshme sipas pjesës 1 të projektit	35,115,000	Shuma për treguesin që lidhet me disburimin (TLD) e përcaktuar në tabelën e aneksit të skedulit 2 të kësaj marrëveshjeje
2. Shërbimet e konsulentëve sipas pjesës 2 të projektit	2,790,000	100%
3. Komision për hapjen e huas (shpenzime menaxhimi)	95,000	Shuma që paguhet në përputhje me seksionin 2.03 të marrëveshjes në përputhje me seksionin 2.07 (b) të kushteve të përgjithshme
Totali	38 000 000	

2. Aneksi i skedulit 2 (Treguesi që lidhet me disburimin (TLD) dhe shuma e TLD amandohet siç përcaktohet në dokumentin bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje.



3. Shtesa (përkufizimet) e marrëveshjes amendohet si vijon:

a) Paragrafi 10 fshihet tërësisht dhe zëvendësohet me paragrafin më poshtë:

“MMSR” ka kuptimin Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Huamarrësit, “Si rrjedhojë, të gjitha referencat për “MPCS” të Marrëveshja amendohen *mutatis mutandis*, që të lexohen “MMSR”.

4. Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes që nuk janë amenduar, do të mbeten të pandryshuara dhe në fuqi dhe efekt të plotë.

Lutem konfirmoni miratimin e Huamarrësit për letrën e mësipërme të amendimit duke nënshkruar, me datën përkatëse dhe duke na dërguar kopjen bashkëlidhur të kësaj letrë për amendimin. Kjo letër për amendimin do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Banka Botërore i përcjellë Huamarrësit njofimin e marrjes së letrës së Huamarrësit me njofimin që zbatimi dhe përcjellja e kësaj letrë

amendimi është autorizuar sipas kuadrit ligjor apo ratifikuar siç parashikohet në legjislacionin shqiptar.

Me respekt,

**BANKA NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Nga: _____

Tahseen Sayed

Menaxher për vendin

Republika e Shqipërisë

Miratuar:

Republika e Shqipërisë

Nga _____

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Data: _____

Dokumenti bashkëlidhur

ANEKS I SKEDULIT 2

TREGUESI QË LIDHET ME DISBURSIMIN (TLD) DHE SHUMA E TLD

Numri	Treguesi që lidhet me disbursimin (TLD)	Shuma e TLD-së (shprehur në euro)
1	Të paktën 90 për qind e administratorëve socialë në të tria rajonet pilote trajnohen në zbatimin e formulës së unifikuar të pikëzimit për programin e ndihmës ekonomike.	1,045,000
2	Të paktën 80 për qind e familjeve në të tria rajonet pilote që marrin përfitimin për programin e ndihmës ekonomike janë shqyrtuar për kriteret e pranueshmërisë duke përdorur formulën e unifikuar të pikëzimit të rënë dakord me Bankën.	1,900,000
3	Të paktën 80 për qind e dosjeve të aplikantëve për ndihmë ekonomike në të tria rajonet pilote janë të plota dhe të pajtueshme me proceset e aplikimit dhe marrjes, duke përdorur formulën e unifikuar të pikëzimit të specifikuar në udhëzimet operative të ndihmës ekonomike të rënë dakord me Bankën.	1,900,000
4	Të paktën 80 për qind e familjeve në gjithë vendin që po përfitojnë nga programi i ndihmës ekonomike janë shqyrtuar për kriteret e pranueshmërisë, duke përdorur formulën e unifikuar të unifikuar të pikëzimit të rënë dakord me Bankën.	2,500,000
5	Kriteret e rishikuara të vlerësimit, procedurat e biznesit dhe marrëveshjet institucionale për Programin e Ndihmës për Personat me Aftësi të Kufizuara, bazuar në modelin social, zhvillohen dhe testohen paraprakisht.	1,900,000
6	Kriteret e vlerësimit, procedurat e biznesit dhe marrëveshjet institucionale për Programin e Ndihmës për Personat me Aftësi të Kufizuara, rishikohen bazuar në modelin social dhe këto rishikime konsultohen, miratohen dhe shpërndahen.	1,900,000
7	Të paktën 66 për qind e aplikimeve të reja dhe kërkesave për ricertifikim në dy zonat pilote janë vlerësuar/rivlerësuar, duke përdorur	2,500,000



Numri	Treguesi që lidhet me disbursimin (TLD)	Shuma e TLD-së (shprehur në euro)
	proceset dhe kriteret e rishikuara bazuar në modelin social	
8	Faza e parë e SIM-së (Sistemit të Informacionit të Menaxhimit) të ndihmës ekonomike zhvillohet dhe testohet, duke përfshirë, modulet funksionale për një regjistër kombëtar të aplikantëve të ndihmës ekonomike, përzgjedhjes së familjeve që përmbushin kriteret e pranimit, regjistrimi, lëshimin e urdhrat të pagesës dhe raportimin.	2,090,000
9	Të paktën 90 për qind e njësive të pushtetit lokal (bashki/komuna) në të tria rajonet pilote përdorin Sistemin e Informacionit të Menaxhimit të automatizuar për të trajtuar regjistrimin për ndihmë ekonomike të aplikantëve, përzgjedhjen e përfituesve, regjistrimin në program dhe urdhrat e pagesës.	2,850,000
10	Informacioni për familje dhe/ose individë të regjistruar si përfitues në Sistemin e Informacionit të Menaxhimit të Ndihmës Ekonomike verifikohen me informacionin përkatës në të paktën 3 sisteme qeveritare informacioni (si: regjistri i taksave, punësimi, automjetet, regjistri i gjendjes civile dhe regjistrimi i bizneseve dhe sistemi i pensioneve).	2,850,000
11	Të paktën 90 për qind e njësive të pushtetit lokal (bashki/komuna) në gjithë vendin përdorin Sistemin e Informacionit të Menaxhimit të ndihmës ekonomike të automatizuar për të trajtuar regjistrimin për ndihmë ekonomike të aplikantëve, përzgjedhjen e përfituesve, regjistrimin në program dhe urdhrat e pagesës; dhe Sistemi i Informacionit të Menaxhimit i Ndihmës Ekonomike zgjerohet për të mbuluar funksionet e fazës së dytë, duke përfshirë një modul inteligjence për biznesin për monitorim dhe vlerësim.	2,850,000
12	Faza e tretë e Sistemit të Informacionit të Menaxhimit të Ndihmës Ekonomike zhvillohet dhe testohet, me funksione të zgjeruara që përfshijnë një modul për “Menaxhim të integruar të rasteve” dhe një lidhje me sistemin e Thesarit për të mundësuar një rakordim/përputhje të automatizuar të pagesave elektronike.	2,090,000
13	Faza e parë e Sistemit të Informacionit të Menaxhimit e Programit të Ndihmës për Personat me Aftësi të Kufizuara zhvillohet dhe testohet, duke përfshirë modulet funksionale për një regjistër kombëtar të aplikantëve të rinj të Programit të Ndihmës për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe përfituesve ekzistues, vlerësimin e kriterëve të pranueshmërisë dhe ricertifikimit, regjistrimin në program, lëshimin e urdhrat të pagesës dhe raportimin.	2,090,000
14	Të paktën 66 për qind e aplikimeve të reja dhe kërkesave për ricertifikim të ardhura në dy zonat pilote janë trajtuar duke përdorur Sistemin e Informacionit të Menaxhimit të automatizuar.	2,850,000
15	Të paktën 75% e rasteve të mashtrimeve të dyshuara dhe gabimeve në ndihmën ekonomike hetohen nga inspektorët socialë në përputhje me legjislacionin dhe politikën e rishikuar të sanksioneve.	1,900,000
16	Zbatohet profilizim i bazuar në risk për të zbuluar gabimet dhe mashtrimet të ndihma ekonomike.	1,900,000



LIGJ
Nr. 118/2016

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET VENDEVE TË BALLKANIT
PERËNDIMOR PËR NGRITJEN E ZYRËS
RAJONALE PËR BASHKËPUNIM RINOR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 10.11.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9855, datë 17.11.2016,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**MARRËVESHJA
PËR NGRITJEN E ZYRËS RAJONALE PËR
BASHKËPUNIMIN RINOR**

Preambulë

Ne, pjesëmarrësit e Ballkanit Perëndimor, në vijim të referuar bashkërisht si “Palët Kontraktuese” dhe individualisht si “Pala Kontraktuese”;

duke pranuar se, në rajon, ne ndajmë shumë ngjashmëri në historitë tona dhe kemi një interes të qartë për të bashkëpunuar dhe për të krijuar shoqëri të stabilizuara që ndërtojnë besim mes njerëzve dhe sigurojnë mirëqenie më të mirë në rajon;

duke rikonfirmuar se Marrëveshja mbi ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor (në vijim e referuar si “Marrëveshja”) ndjek objektivat e përcaktuar si pjesë e “Procesit të Berlinit” dhe

bazuar në “Deklaratën e përbashkët për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor në Ballkanin Perëndimor” (në vijim e referuar si “Deklarata”), e nënshkruar më 27 gusht 2015, në Konferencën e Ballkanit Perëndimor, në Vjenë, Austri;

duke vërejtur se Palët Kontraktuese kanë punuar në partneritet me shoqërinë civile për të hapur rrugën për ngritjen e një mekanizmi institucional në kuadër rajonal me mandat dhe kapacitet për të krijuar kushtet dhe për të mbështetur aktivitetet që nxisin pajtimin, lëvizshmërinë, diversitetin, vlerat demokratike, pjesëmarrjen, qytëtarinë aktive dhe të mësuarit ndërkulturore, duke pasur ndër mend frymën e procesit të integritetit evropian në rajon;

duke marrë në konsideratë se vizioni për Zyrën Rajonale për Bashkëpunimin Rinor (në vijim e referuar si “ZRBR”) është që të mbështesë një rajon me diversitet në të cilin të rinjtë, si grupi me interesin më të madh për të investuar tek e ardhmja, janë të ndërgjegjshëm për të kaluarën dhe luajnë rol aktiv në ndërtimin e një të ardhmeje më të begatë për shoqëritë e tyre;

duke theksuar se ZRBR-ja, si një mekanizëm institucional që funksionon në mënyrë të pavarur, ngrihet mbi bazën e vlerave të paqes, besimit e bazuar në mirëkuptimin reciprok, respektin për të drejtat e njeriut, diversitetin, dinjitetin, solidaritetin, bashkëpunimin, tolerancën dhe respektin, dhe nënkupton një mirëkuptim se vetëm nëpërmjet veprimit të përbashkët ne mund të ecim para si një rajon;

duke mirëpritur qasjen gjithëpërfshirëse dhe të barabartë për shkëmbimet e të rinjve që do t’u mundësojë të rinjve të përdorin këtë mekanizëm institucional mbështetës, për realizim projektesh novatore me kuadër rajonal;

duke pasur parasysh se ky do të jetë një kontribut unik në dëshirën për të përmirësuar mirëkuptimin e realiteteve të shoqërive të njëri-tjetrit, duke u mundësuar të rinjve të takohen, të njihen, të krijojnë shoqëri dhe të angazhohen në dialog rajonal në çështje që do t’i mbështesin ata për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Ngrihet Zyra Rajonale për Bashkëpunimin Rinor me seli në Tiranë, Shqipëri.



Neni 2

Misioni i ZRBR-së është:

a) të mbështesë shkëmbimet rajonale të të rinjve, ndarjen mes tyre të ideve, si një bazë për perspektivat e bashkëpunimit në të ardhmen në rajonin tonë, bazuar në vlerat e bashkekzistencës, tolerancës dhe respektit për të drejtat e njeriut dhe diversitetin, si dhe angazhimin për gjithëpërfshirjen dhe sigurinë;

b) të rrisë bashkëpunimin rajonal ndërmjet të rinjve dhe institucioneve që u kushtohen të rinjve dhe të sigurojë zbatimin e programeve të përbashkëta për të rinjtë, me fokusin mbi parimet e qeverisjes demokratike, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, arsimin dhe inovacionin;

c) të koordinojë bashkëpunimin e të rinjve në Ballkanin Perëndimor.

Neni 3

1. Statuti i ZRBR-së miratohet me këtë marrëveshje dhe do të përbëjë një aneks të saj.

2. Do të lidhet një Marrëveshje mbi Vendin Pritës ndërmjet ZRBR-së dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

ZRBR-ja dhe kategori të caktuara të personelit, do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetin e nevojshëm për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të tyre, të cilat do të përcaktohen në Marrëveshjen mbi Vendin Pritës.

Neni 5

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim për Palët Kontraktuese.

2. Kjo Marrëveshje do të miratohet në pajtim me legjislacionin përkatës të secilës prej Palëve Kontraktuese dhe do të hyjë në fuqi në ditën që depozitohet te Depozitari instrumenti i fundit që certifikon miratimin në fjalë.

Neni 6

1. Me hyrjen në fuqi, kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për aderim për palë të tjera në bazë të konsensusit paraprak të të gjitha Palëve Kontraktuese,

2. Për një palë aderuese, kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e depozitimit të instrumentit të aderimit te Depozitari.

Neni 7

Kjo Marrëveshje do të ketë zbatim të përkohshëm duke filluar nga data e nënshkrimit deri në datën e hyrjes në fuqi në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës të Palëve Kontraktuese.

Neni 8

1. Kjo Marrëveshje dhe aneksi bashkëlidhur mund të amendohen në bazë të aprovimit me shkrim të të gjitha Palëve Kontraktuese.

2. Çdo propozim i tillë do t'u komunikohet Palëve Kontraktuese nga Sekretari i Përgjithshëm të paktën 3 muaj para paraqitjes për miratim te Bordi Drejtues.

3. Amendimet e miratuara, siç referohet në paragrafin 2, do të jenë objekt i miratimit dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e legjislacionit kombëtar përkatës të parashtruar në nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

1. Secila Palë Kontraktuese mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje në çdo kohë nëpërmjet depozitimit të njoftimit me shkrim te Depozitari, dhe një kopje e vërtetuar e këtij njoftimi do t'i përcillet nga Depozitari secilës prej Palëve Kontraktuese.

2. Tërheqja nga Marrëveshja do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës së depozitimit të njoftimit.

3. Një Palë Kontraktuese nuk do të çlirohet, për arsye të tërheqjes, nga detyrimet financiare që janë akumuluar ndërsa ajo ka qenë Palë Kontraktuese e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

1. Këshilli i Ministrave i Shqipërisë do të veprojë si Depozitari i kësaj Marrëveshjeje.

2. Dokumenti origjinal i kësaj Marrëveshjeje në një kopje të vetme në gjuhën angleze, do të depozitohet te Depozitari që do t'u përcjellë një kopje të vërtetuar secilës prej Palëve Kontraktuese.

Neni 11

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi apo zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen nëpërmjet konsultimit dhe bisedimeve ndërmjet Palëve Kontraktuese.



Neni 12

Kjo Marrëveshje me aneksin bashkëlidhur përbën një instrument me detyrim ligjor ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar sipas ligjit nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Paris, më 4 korrik, të vitit dy mijë e gjashtëmbëdhjetë në një kopje të vetme origjinale në gjuhën angleze.

Për Shqipërinë, *Kryeministri, Z. Edi RAMA*

Për Bosnjë-Hercegovinën, *Kryetari i Këshillit të Ministrave, Z. Denis ZVICIC*

Për Kosovën¹, *Kryeministri, Z. Isa MUSTAFA*

Për Maqedoninë, *Kryeministri, Z. Emil DIMITRIEV*

Për Malin e Zi, *Kryeministri, Z. Milo DUKANOVIC*

Për Serbinë, *Kryeministri, Aleksandër VUCIC*

Aneks: Statuti i Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor

**STATUT I ZYRËS RAJONALE
PËR BASHKËPUNIMIN RINOR
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Zyra Rajonale për Bashkëpunimin Rinor do të jetë një mekanizëm institucional me funksionim të pavarur për bashkëpunimin rinor ndërmjet pjesëmarrësve të Ballkanit Perëndimor.

Neni 2

1. Struktura ligjore e ZRBR-së do të vendoset në Tiranë, Shqipëri, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

2. Shkurtimi për Zyrën Rajonale për Bashkëpunimin Rinor është “ZRBR”.

3. ZRBR-ja do të ketë logon e vet.

Neni 3

1. Sekretariati i ZRBR-së ka zyrën qendrore në Tiranë, Shqipëri.

2. Sekretariati mund t'i propozojë Bordit Drejtues për të ngritur degë lokale si ta çmojë të përshtatshme në secilën nga Palët Kontraktuese.

3. Dega lokale në Palën Kontraktuese ku vendoset selia do të jetë pjesë integrale e Zyrës Qendrore të Sekretariatit.

Neni 4

1. ZRBR-ja do të ketë një personalitet ligjor dhe një cilësi juridike të nevojshme për të kryer funksionet e veta dhe për të përmbushur mandatin e vet. Këto përfshijnë lidhjen e kontratave, marrjen dhe zotërimin e pronave të tundshme dhe të patundshme, menaxhimin e të gjitha sendeve të saj pasurore, dhe fillimin e procedimeve ligjore në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese.

2. Pala Kontraktuese ku do të vendoset selia, pa vonesë, do të angazhohet për sigurimin e të gjithë dokumentacionit përkatës për qëllimin e rregullimit të statusit ligjor që nevojitet për ngritjen e ZRBR-së.

3. Qeveria e Palës Kontraktuese ku do të vendoset selia do t'i sigurojë Zyrës Qendrore të Sekretariatit, pa pagesë dhe pa efekte mbi buxhetin dhe kontributet e ZRBR-së, ambientet dhe shërbimet publike që çmohen të nevojshme për një përmbushje efektive dhe efikase të detyrave të ZRBR-së.

4. Kostot në lidhje me ambientet dhe shërbimet publike të degëve lokale që do të vendosen në secilën Palë Kontraktuese përveç asaj të Palës Kontraktuese ku do të jetë selia qendrore, do të mbulohen në mënyrë të plotë nga qeveria në vendin ku do të vendosen, dhe nuk do të kenë efekte mbi buxhetin dhe kontributet e ZRBR-së.

5. Sekretariati, përfshirë edhe degët lokale, nuk do të vendoset në godina me organe të tjera të administratës publike të Palës Kontraktuese, atje ku janë vendosur.

ANËTARËSIMI

Neni 5

1. Anëtarët themelues të ZRBR-së janë Nënshkruesit e Marrëveshjes mbi Ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor.

2. Palë të tjera mund të bëhen anëtarë të ZRBR-së në përputhje me nenin 6 të kësaj Marrëveshje.

¹ Ky përcaktim nuk cenon pozicionet mbi statusin, dhe në përputhje me vendimin UNSCR 1244 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Neni 6

ZRBR-ja është një bashkëpunim i hapur mbi projekte dhe/ose programe me pjesëmarrës të tjerë të interesuar. Ky bashkëpunim do të bazohet mbi një Marrëveshje të Posaçme që përcakton kuadrin dhe synimet e bashkëpunimit. Bashkëpunimi do të kryhet në përputhje me Rregullat e Procedurës së ZRBR-së.

MANDATI I ZRBR-së

Neni 7

1. Mandati i ZRBR-së është të mbështesë projektet rinore që synojnë në, dhe kontribuojnë për:

- Nxitjen e diversitetit dhe vlerave demokratike;
- Rritjen e bashkëpunimit rajonal të qëndrueshëm mes të rinjve, dhe krijimin e marrëdhënieve të reja ndërmjet të rinjve në rajonin e Ballkanit Perëndimor;
- Inkurajimin e pajtimit dhe qasjeve konstruktive për kujtesën;
- Të mësuarin ndërkulturore;
- Rritjen e lëvizshmërisë rajonale;
- Nxitjen e frymës së bashkëpunimit, mirëkuptimit, tolerancës;
- Pjesëmarrjen dhe qytetarinë aktive në proceset e vendimmarrjes për të rinjtë;
- Përfshirjen sociale dhe nxitjen e punësimit të të rinjve.

2. Mandati i ZRBR-së siç përcaktohet nën këtë nen do të aplikohet për çdo Palë të re Kontraktuese të ZRBR-së dhe për bashkëpunimin që do të ndërtohet me pjesëmarrës të tjerë.

Neni 8

ZRBR-ja do të sigurojë mbështetje të plotë për programet rinore të shkëmbimit dhe për aktivitete të tjera që përfshijnë të rinj nga Palët Kontraktuese dhe partnerë që do të jenë në përputhje me dhe do të kontribuojnë për përmbushjen e misionit, vizionit dhe mandatit të ZRBR-së.

Neni 9

Organizata dhe persona të përshtatshëm nga Palët Kontraktuese mund të aplikojnë për mbështetje, me qëllim që të organizohen aktivitete shkëmbimi, të cilat do të jenë në përputhje me, dhe do të kontribuojnë për përmbushjen e misionit, vizionit dhe mandatit të ZRBR-së.

Neni 10

Në miratimin e propozimeve për projekte do të vihet theksi mbi garantimin që projektet e financuara nga ZRBR-ja të marrin në konsideratë cilësinë e propozimeve, kontributet përkatëse të Palëve Kontraktuese në buxhetin e ZRBR-së siç përcaktohet në nenin 44 dhe prioritetet e ZRBR-së, siç përshkruhen në planin e saj operativ.

Neni 11

Secila nga Palët Kontraktuese do të sigurojë mbështetje të plotë për zbatimin e projekteve me Palët e tjera Kontraktuese.

Neni 12

Rregullore shtesë dhe më specifike që përcaktojnë aktivitetet dhe përshtatshmërinë e aplikantëve, do të përcaktohen në udhëzimet e ZRBR-së për aplikantët, të cilat do të përpunohen nga Sekretariati dhe do të miratohen nga Bordi Drejtues.

STRUKTURA E ZRBR-së

Neni 13

Strukturat e ZRBR-së do të përbëhen nga:

1. Një Bord Drejtues;
2. Një Sekretariat;
3. Një Bord Këshillimor;
4. Grupe pune.

BORDI DREJTUES

Neni 14

1. Bordi Drejtues është autoriteti më i lartë vendimmarrës i ZRBR-së.

2. Bordi Drejtues përbëhet nga dy përfaqësues nga secila Palë Kontraktuese siç përshkruhet, më poshtë:

- Një përfaqësues qeveritar që është përgjegjës i drejtpërdrejtë për politikën rinore;
- Një përfaqësues rinor.

Neni 15

Përfaqësuesi qeveritar shërben për një periudhë në përputhje me mandatin e tij ose të saj në qeverinë e Palës Kontraktuese që përfaqëson.



Neni 16

1. Përfaqësuesi rinor nuk do të jetë nën 18 vjeç, dhe jo më shumë se 30 vjeç në fillim të mandatit të saj/tij.

2. Përfaqësuesi rinor do të shërbejë për një mandat 3 vjet, pa mundësi për zgjatje mandati.

3. Secila Palë Kontraktuese do të përzgjedhë një përfaqësues rinor duke përdorur mekanizmat e veta në një mënyrë transparente, gjithëpërfshirëse dhe demokratike, dhe në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile që merret me të rinjtë.

Neni 17

Vendimet e Bordit Drejtues merren me konsensus.

Neni 18

Bordi Drejtues:

1. Do të përcaktojë Rregullat e Procedurës dhe rregullore të tjera dytësore për funksionimin e ZRBR-së;

2. Do të përcaktojë një plan strategjik 3-vjeçar dhe plane operative vjetore të ZRBR-së;

3. Do të përcaktojë buxhetin vjetor të ZRBR-së dhe planin e saj financiar për periudhën 3-vjeçare në vijim;

4. Do të miratojë Raportin Vjetor të Programit;

5. Do të miratojë Raportin Financiar Vjetor;

6. Do të sigurojë mbështetje politike për planet strategjike, operative dhe financiare të ZRBR-së nga Palët Kontraktuese;

7. Do të autorizojë Bordin Këshillimor në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm për të ngritur grupe pune mbi një çështje të posaçme që lidhet me të rinjtë, brenda kuadrit të mandatit të ZRBR-së;

8. Do të emërojë Sekretarin e Përgjithshëm bazuar në meritat dhe kompetencat e kandidatëve, dhe do të shkarkojë Sekretarin e Përgjithshëm;

9. Do të lidhë dhe përfundojë marrëveshje për bashkëpunim me pjesëmarrës dhe organizata jashtë Palëve Kontraktuese të ZRBR-së;

10. Do të ngrëjë një Komitet Përzgjedhës në të cilin Sekretari i Përgjithshëm do të jetë anëtar, i ngarkuar me detyrën e procesit të përzgjedhjes për stafin e Sekretariatit dhe degëve lokale;

11. Do të caktojë auditues financiarë të jashtëm për ZRBR-në në përputhje me këtë statut;

12. Do të kryejë detyra të tjera siç përcaktohet në këtë Statut.

Faqe | 23820

Neni 19

1. Bordi mbledhet një herë në vit, me përjashtim të rasteve kur vendoset ndryshe.

2. Mbledhja e Bordit bëhet te Pala Kontraktuese që e kryeson dhe drejtohet nga Kryesia.

3. Kryesia përbëhet nga një përfaqësues qeveritar dhe një përfaqësues rinor nga e njëjta Palë Kontraktuese.

4. Përfaqësuesi rinor do të asistojë, dhe kur nevojitet, do të zëvendësojë përfaqësuesin qeveritar në drejtimin e mbledhjes.

5. Kryesia kryen rotacion çdo vit sipas rendit alfabetik të emrave të Palëve Kontraktuese.

6. Kostot e pjesëmarrjes së anëtarëve të Bordit Drejtues do të përfshihen në buxhetin e Sekretariatit të ZRBR-së.

Neni 20

Kryetari:

1. Do të drejtojë mbledhjet e Bordit Drejtues;

2. Do të mbështesë Sekretariatin e Përgjithshëm në përmbushjen e mandatit, në përfaqësimin e ZRBR-së, duke përfshirë edhe përpjekjet për ngritje fondesh jashtë Palëve Kontraktuese të ZRBR-së.

SEKRETARIATI

Neni 21

1. Sekretariati përbëhet nga Zyra Qendrore dhe degët lokale që mund të ngrihen në përputhje me nenin 3 të statutit.

2. Zyra Qendrore është e vendosur në Tiranë, Shqipëri dhe përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm, zëvendëssekretari i përgjithshëm, si dhe nga stafi administrativ, mbështetës dhe stafi i programit.

3. Sekretariati do të funksionojë në përputhje me rregullat e procedurës.

Neni 22

1. Një Komitet Përzgjedhës, i ngritur nga Bordi, do të përpunojë kriteret përzgjedhëse për stafin e Sekretariatit dhe do të përzgjedhë kandidatët.

2. Kandidatët për stafin e Sekretariatit do të identifikohen nëpërmjet një thirrjeje të hapur. Kandidatët do të vlerësohen dhe punësohen bazuar në merita dhe duhet të reflektojnë diversitetin e Palëve Kontraktuese të ZRBR-së.



Neni 23

1. Staf i lokal i Zyrës Qendrore të ZRBR-së dhe degëve lokale do të punësohen sipas kushteve në përputhje me legjislacionin në fuqi në secilën Palë Kontraktuese.

2. Do të merren masa për të mundësuar angazhimin e praktikantëve në strukturat e ZRBR-së.

Neni 24

1. Kandidatët për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm përzgjidhen nëpërmjet një thirrjeje të hapur dhe bazuar në merita.

2. Sekretari i Përgjithshëm emërohet për një mandat 4-vjeçar, me konsensus të Bordit Drejtues, pa mundësi për zgjatje mandati.

3. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës para Bordit Drejtues.

4. Kombësia e Sekretarit të Përgjithshëm do të përcillet me rotacion në një mënyrë gjithëpërfshirëse për të gjitha Palët Kontraktuese të ZRBR-së.

5. Sekretari i parë i Përgjithshëm nuk mund të jetë nga Pala Kontraktuese ku është vendosur Zyra Qendrore e ZRBR-së.

Neni 25

1. Kandidatët për pozicionin e zëvendëssekretarit të përgjithshëm përzgjidhen nëpërmjet një thirrjeje të hapur dhe bazuar në merita.

2. Zëvendëssekretari i përgjithshëm emërohet për një mandat 4-vjeçar, me konsensus të Bordit Drejtues, pa mundësi për zgjatje mandati.

3. Zëvendëssekretari i përgjithshëm është përgjegjës para Sekretarit të Përgjithshëm dhe Bordit Drejtues.

4. Zëvendëssekretari i përgjithshëm nuk do të jetë me të njëjtën kombësi si Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 26

Bordi Drejtues do të sigurojë që të funksionojë një periudhë e përshtatshme e dorëzimit të funksioneve ndërmjet sekretarëve të përgjithshëm dhe zëvendëssekretarëve të përgjithshëm që largohen dhe atyre që vijnë.

Neni 27

Zyra Qendrore e ZRBR-së është përgjegjëse për sa më poshtë:

1. Përgatitjen e draftit të Planit Strategjik, planeve operative, në konsultim me Bordin Këshillimor;

2. Zbatimin e Planit Strategjik dhe Planeve Operative pasi të jenë miratuar nga Bordi Drejtues;

3. Propozimin e buxhetit vjetor të ZRBR-së dhe planin financiar për periudhën 3-vjeçare në vijim;

4. Të gjitha çështjet ditore financiare në përputhje me rregulloret financiare, duke përfshirë edhe propozimet për rialokim buxhetor që është brenda 5% të kostove të paparashikueshme;

5. Të gjitha çështjet e programit, përfshirë programimin, formulimin dhe botimin e thirrjeve për propozime, përzgjedhjen e propozimeve, tenderimin, asistencën në përgatitjen e aplikimeve, asistencën për zbatimin, shqyrtimin e raporteve të projektit, kryerjen e kontroleve në terren për projekte të financuara nga ZRBR-ja dhe raportimin në këtë kuadër;

6. Komunikimin me donatorët, kur nuk janë Palët Kontraktuese dhe sigurimin e mbështetjes financiare shtesë për ZRBR-në në bashkëpunim me Kryesinë e Bordit Drejtues;

7. Organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve për promovimin, vizibilitetin dhe shtrirjen e ZRBR-së;

8. Organizimin e proceseve përzgjedhëse për stafin e Zyrës Qendrore dhe degëve lokale në përputhje me kriteret e përzgjedhjes dhe nën mbikëqyrjen e Komitetit Përzgjedhës të ngritur nga Bordi Drejtues;

9. Garantimin për respektimin e rregulloreve financiare dhe rregullave të procedurës;

10. Koordinimin e punës ndërmjet Zyrës Qendrore dhe degëve lokale;

11. Botimin e thirrjeve dhe caktimin e Komitetit për Vlerësimin e Propozimeve;

12. Zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e ndikimit të masave të kontrollit të cilësisë, të tilla si: ndërtim kapacitetesh, trajnime, kërkim, monitorim dhe vlerësim;

13. Përgatitjen e mbledhjeve të Bordit Drejtues në bashkëpunim me Kryesinë;

14. Të gjitha çështjet e tjera operative dhe administrative.

Neni 28

Sekretari i Përgjithshëm:

1. Do të përfaqësojë ZRBR-në dhe interesat e saj;



2. Do të kryejë, mbikëqyrë dhe koordinojë punën e Sekretariatit;

3. Do të përgatisë dhe paraqesë te Bordi Drejtues raportet financiare dhe ato të programit, siç përcaktohet në rregullat e procedurës;

4. Do të realizojë dhe do të përfundojë kontratat me stafin e Zyrës Qendrore dhe degëve lokale, në përputhje me rregullat e procedurës;

5. Do të realizojë marrëveshje ndërkombëtare në emër të ZRBR-së, me autorizim nga Bordi Drejtues;

6. Do të realizojë dhe do të përfundojë kontrata me Palët e Zbatimit të Projektit;

7. Do të realizojë dhe do të përfundojë kontrata me furnizuesit;

8. Do të kryejë detyra të tjera në përputhje me statutin dhe rregullat e procedurës.

Neni 29

Zëvendëssekretari i përgjithshëm do të asistojë Sekretarin e Përgjithshëm në përmbushjen e mandatit të tyre dhe në mënyrë specifike do të jetë përgjegjës për sa më poshtë:

1. Të mbikëqyrë dhe të koordinojë punën me Sekretariatin në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm.

2. Të garantojë respektimin e rregullave të procedurës dhe rregulloreve financiare nga i gjithë stafi brenda Sekretariatit.

3. Të koordinojë punën e Bordit Këshillimor.

Neni 30

Degët lokale janë përgjegjëse për sa më poshtë:

1. Përfaqësimin e ZRBR-së në nivelin e Palës Kontraktuese, atje ku janë vendosur në bashkëpunim me Zyrën Qendrore;

2. Zbatimin e Planit Strategjik dhe planeve operative për Palën Kontraktuese, në bashkëpunim me Zyrën Qendrore;

3. Dhënien e asistencës në aplikimin për projektin, zbatimin dhe raportimin për Palët për zbatimin e Projektit të Pala Kontraktuese, atje ku është vendosur;

4. Kryerjen e aktiviteteve në vijimësi dhe për kontrollë në terren ndaj Palëve për zbatimin e Projektit në bashkëpunim me Zyrën Qendrore;

5. Koordinimin e aktiviteteve për promovimin, vizibilitetin dhe zgjerimin për Palën Kontraktuese atje ku është vendosur, në bashkëpunim me Zyrën Qendrore;

Faqe | 23822

6. Përgatitjen dhe dërgimin e raporteve të programit, raporteve operative e financiare te Sekretari i Përgjithshëm, siç përcaktohet në Rregullat e Procedurës.

BORDI KËSHILLIMOR

Neni 31

Bordi Këshillimor formohet nga ekspertë në çështjet tematike të ZRBR-së, duke përfshirë përfaqësues të komunitetit të donatorëve, shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve të tjera përkatëse.

Neni 32

1. Anëtarët e Bordit Këshillimor rekomandohen nga Bordi Drejtues dhe nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Anëtarët e Bordit Këshillimor emërohen zyrtarisht nga Bordi Drejtues.

Neni 33

1. Anëtarët e Bordit Këshillimor emërohen për një mandat 2-vjeçar, me mundësi për zgjatje mandati.

2. Secila Palë Kontraktuese ka tre anëtarë në Bordin Këshillimor. Për secilën Palë Kontraktuese, dy anëtarë rekomandohen nga Bordi Drejtues ndërsa një rekomandohet nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 34

1. Bordi Këshillimor, me iniciativë të vet dhe/ose me autorizim nga Bordi Drejtues dhe/ose Sekretari i Përgjithshëm, mund të kryejë studime dhe vlerësime, dhe të japë rekomandime mbi çështje brenda kuadrit të aktiviteteve dhe mandatit të ZRBR-së.

2. Bordi Këshillimor mund të formojë grupe pune të përbërë nga anëtarë të tij dhe ekspertë të jashtëm, me rekomandim nga Bordi Drejtues.

3. Bordi Këshillimor i raporton Bordit Drejtues dhe Sekretarit të Përgjithshëm.

DISPOZITAFINANCIARE

Neni 35

Buxheti total vjetor i ZRBR-së për periudhën e parë buxhetore 3-vjeçare do të jetë 2,000,000.00 EURO në vit.



Neni 36

Qeveritë e Palëve Kontraktuese do të sigurojnë angazhimin afatgjatë financiar për qëndrueshmërinë e strukturave të ZRBR-së, dhe përmbushjen e mandatit të ZRBR-së siç përcaktohet në nenin 7 të këtij statuti. Si pjesë e kësaj, shuma e kontributeve të të gjitha Palëve Kontraktuese të ZRBR-së nuk do të jetë më e ulët se 50% + 1 EURO e buxhetit të ZRBR-së në një vit të caktuar.

Neni 37

1. Buxheti i ZRBR-së do të përbëhet nga kontributet nga Palët Kontraktuese të ZRBR-së dhe kontributet nga donatorë të tjerë, siç përshkruhet në nenin 45.

2. Kontributet nga donatorë të tjerë që tejkalojnë shumën totale të buxhetit vjetor të ZRBR-së do të përfshihen në një Fond të Posaçëm Bashkëfinancimi në përputhje me misionin e ZRBR-së.

Neni 38

Fondet që do të mundësohen nëpërmjet Fondit të Posaçëm të Bashkëfinancimit do të përdoren në mënyrë ekskluzive për kostot e aktiviteteve të ZRBR-së siç përcaktohet në nenin 46 të këtij Statuti si për financimin ashtu edhe për bashkëfinancimin e aktiviteteve të ZRBR-së.

Neni 39

Kostot operative të Sekretariatit të ZRBR-së, siç përcaktohet në nenin 46 të këtij statuti, nuk do të tejkalojnë nivelin e 15% të buxhetit total të ZRBR-së.

Neni 40

Rregulloret financiare do të jenë pjesë e rregullave të procedurës dhe do të mbulojnë të gjitha aspektet financiare të ZRBR-së, duke përfshirë edhe ato që nuk përmenden në mënyrë specifike në këtë statut.

Neni 41

Kontributet e secilës nga Palët Kontraktuese të ZRBR-së të buxheti i ZRBR-së do të shprehen si përqindje, siç përcaktohet në nenin 44 të këtij statuti.

Neni 42

1. Buxheti i ZRBR-së planifikohet mbi bazë trevjeçare dhe miratohet çdo vit.

2. Buxheti për periudhën trevjeçare në vijim do të finalizohet 6 muaj para se të skadojë buxheti aktual, dhe duke përdorur treguesit më të fundit të disponueshëm për aspektin ekonomik dhe atë të popullsisë që kërkohen për llogaritjen e kontributit të secilës Palë Kontraktuese të ZRBR-së.

Neni 43

Palët Kontraktuese do të bien dakord në mënyrë unanime për çdo rritje të kontributeve të Palës Kontraktuese të buxheti i ZRBR-së.

Neni 44

1. Përqindjet e kontributeve të Palëve Kontraktuese të buxheti i ZRBR-së, në përputhje me nenin 37 të këtij statuti, janë si më poshtë:

- Shqipëria: 17.3%
- Bosnjë dhe Hercegovina: 15.4%
- Kosova*: 10.2%
- Maqedonia: 13.8%
- Mali i Zi: 4.4%
- Serbia: 38.9%

Neni 45

ZRBR-ja mund të marrë fonde edhe nga palë të tjera përveç Palëve të saj Kontraktuese, në përputhje me misionin e ZRBR-së, si më poshtë nga:

1. Organizatat ndërkombëtare;
2. Fondacione kombëtare dhe ndërkombëtare;
3. Donatorë kombëtarë dypalësh, si për shembull fonde të bashkëpunimit për zhvillim;
4. Donacione korporative;
5. Donatorë individualë.

Neni 46

Kostot e Sekretariatit të ZRBR-së përbëhen nga kostot operative dhe kostot e aktiviteteve.

Kosto operative, janë:

1. Kostot e personelit;
2. Kostot e automjeteve (përfshirë karburantin, regjistrimin, siguracionin, riparimet etj.);
3. Kostot e pajisjeve (kompjuter, makina fotokopjuese, telefona, faks, skaner, artikuj shkrimi /kancelari etj.);
4. Kostot e komunikimit;



5. Kostot e pastrimit;
 6. Kostot e vizitave në terren;
 7. Kostot e udhëtimit për mbledhje, konferenca etj.;
 8. Kostot për trajnime personeli dhe ndërtim ekipesh;
 9. Kostot e takimeve të Bordit Drejtues;
- Kostot e aktiviteteve janë si më poshtë:
1. Kostot e aktiviteteve të projektit;
 2. Kostot e vlerësimit të propozimeve të projekteve;
 3. Kostot e shpërndarjes;
 4. Kostot për vizibilitetin;
 5. Kostot për trajnimin e trajnerëve.

Neni 47

Kostot jo për Sekretariatit e ZRBR-së janë si më poshtë:

1. Qiraja për hapësirën e Zyrës Qendrore për Sekretariatit dhe degët lokale;
2. Faturat e shërbimeve publike (energji, gaz, ujë, mbledhje e mbetjeve);
3. Mirëmbajtja dhe rinovimi i ndërtesës (që nuk është për shkak të dëmit apo pakujdesisë së personelit të ZRBR-së).

Neni 48

1. Të gjitha procedurat tenderuese të Sekretariatit do të bazohen në udhëzimet e përcaktuara në versionin më të fundit të Manualit Praktik dhe Procedurave të Komisionit Evropian.

2. Sekretariati do të inkurajohet të zhvillojë procedurat e veta tenderuese.

Neni 49

Të gjitha pajisjet që do të blihen nëpërmjet buxhetit të ZRBR-së, të tilla si: automjete, pajisje të TIK etj., janë në pronësi të Sekretariatit të ZRBR-së në përputhje me dispozitat e rregulloreve financiare.

Neni 50

Projektet e mbështetura nga ZRBR-ja do të kërkojnë bashkëfinancim nga pala përfituese, në varësi të kapacitetit të aplikantit dhe tipit të projektit.

1. Për shkëmbime individuale ZRBR-ja do të mbulojë deri në 100% të kostove totale të projektit.

2. Për shkëmbime në grup ZRBR-ja do të mbulojë deri në 75% të kostove totale të projektit për Palët Zbatuese të Projektit, me një buxhet vjetor më të lartë se 300,000 EURO.

3. Për Palët Zbatuese të Projektit me një buxhet vjetor midis 50,000 EURO dhe 300,000 EURO, ZRBR-ja do të mbulojë deri në 85% të kostove totale të projektit.

4. Për Palët Zbatuese të Projektit me një buxhet vjetor më të ulët se 50,000 EURO, ZRBR-ja do të mbulojë deri në 95% të kostove totale të projektit.

Neni 51

Të gjitha operacionet financiare të ZRBR-së, duke përfshirë kontributet qeveritare, do të kryhen në monedhën EURO.

VENDIM

Nr. 776, datë 2.11.2016

PËR SHPALLJEN E QENDRËS HISTORIKE TË FSHATIT BËNJË DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN E SAJ E TË ZONËS SË MBROJTUR PËRRETH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 29, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Bënjë, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike, bashkëlidhur këtij vendimi.


2. Miratimin e rregullore “Për administrimin e Qendrës Historike të fshatit Bënjë dhe zonës së mbrojtur përreth”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

MIRATOHET

KRYETARI I KËSHILLIT TË
MINISTRAVE

Z. EDI RAMA

MINISTRIA E KULTURËS
MINISTËR

Znj. MIRELA KUMBARO FURXHI

INSTITUTI I MONUMENTEVE
TË KULTURËS

DREJTOR

Znj. ARTA DOLLANI



TABELA 1

QENDRA HISTORIKE E FSHATIT BËNJË						
KOORDINATA GJEOGRAFIKE						
Pika	Gjatësi			Gjerësi		
	gradë	minuta	sekonda	gradë	minuta	sekonda
B. 1	40°	15'	6.85 "N	20°	25'	1.55 "E
B. 2	40°	15'	7.01 "N	20°	25'	3.32 "E
B. 3	40°	15'	6.90 "N	20°	25'	4.25 "E
B. 4	40°	15'	5.92 "N	20°	25'	4.41 "E
B. 5	40°	15'	5.07 "N	20°	25'	3.97 "E
B. 6	40°	15'	4.65 "N	20°	25'	4.45 "E
B. 7	40°	15'	3.49 "N	20°	25'	3.95 "E
B. 8	40°	15'	2.93 "N	20°	25'	0.16 "E
B. 9	40°	15'	2.98 "N	20°	24'	59.61 "E
B. 10	40°	15'	4.40 "N	20°	24'	58.63 "E
B. 11	40°	15'	4.43 "N	20°	24'	57.98 "E
B. 12	40°	15'	4.81 "N	20°	24'	57.67 "E
B. 13	40°	15'	4.75 "N	20°	24'	56.46 "E
B. 14	40°	15'	4.59 "N	20°	24'	56.37 "E
B. 15	40°	15'	4.68 "N	20°	24'	55.28 "E
B. 16	40°	15'	5.33 "N	20°	24'	54.80 "E
B. 17	40°	15'	5.85 "N	20°	24'	54.65 "E
B. 18	40°	15'	6.44 "N	20°	24'	55.29 "E
B. 19	40°	15'	7.12 "N	20°	24'	55.77 "E
B. 20	40°	15'	7.45 "N	20°	24'	55.73 "E
B. 21	40°	15'	7.73 "N	20°	24'	56.10 "E
B. 22	40°	15'	7.56 "N	20°	24'	56.54 "E
B. 23	40°	15'	7.74 "N	20°	24'	57.20 "E
B. 24	40°	15'	8.04 "N	20°	24'	57.66 "E
B. 25	40°	15'	7.94 "N	20°	24'	58.04 "E
B. 26	40°	15'	8.51 "N	20°	24'	58.58 "E
B. 27	40°	15'	8.53 "N	20°	24'	59.05 "E
B. 28	40°	15'	8.74 "N	20°	24'	59.43 "E
B. 29	40°	15'	7.88 "N	20°	25'	1.22 "E
B. 30	40°	15'	7.38 "N	20°	25'	1.60 "E



TABELA 2

ZONA E MBROJTUR E QENDRËS HISTORIKE TË FSHATIT BËNJË						
KOORDINATA GJEOGRAFIKE						
Pika	Gjatësi			Gjerësi		
	gradë	minuta	sekonda	gradë	minuta	sekonda
Z. 1	40°	15'	8.36 "N	20°	25'	1.83 "E
Z. 2	40°	15'	7.14 "N	20°	25'	5.10 "E
Z. 3	40°	15'	5.57 "N	20°	25'	6.87 "E
Z. 4	40°	15'	3.73 "N	20°	25'	8.63 "E
Z. 5	40°	15'	2.59 "N	20°	25'	8.46 "E
Z. 6	40°	15'	1.31 "N	20°	25'	8.48 "E
Z. 7	40°	15'	0.72 "N	20°	25'	7.60 "E
Z. 8	40°	15'	0.64 "N	20°	25'	5.34 "E
Z. 9	40°	15'	1.58 "N	20°	25'	1.71 "E
Z. 10	40°	15'	2.45 "N	20°	24'	58.97 "E
Z. 11	40°	15'	3.29 "N	20°	24'	57.60 "E
Z. 12	40°	15'	4.03 "N	20°	24'	56.15 "E
Z. 13	40°	15'	4.28 "N	20°	24'	54.83 "E
Z. 14	40°	15'	5.20 "N	20°	24'	53.84 "E
Z. 15	40°	15'	6.45 "N	20°	24'	54.09 "E
Z. 16	40°	15'	7.63 "N	20°	24'	53.85 "E
Z. 17	40°	15'	8.69 "N	20°	24'	54.32 "E
Z. 18	40°	15'	8.80 "N	20°	24'	56.98 "E
Z. 19	40°	15'	9.10 "N	20°	24'	58.71 "E
Z. 20	40°	15'	9.09 "N	20°	24'	59.63 "E
Z. 21	40°	15'	9.43 "N	20°	25'	0.47 "E
Z. 22	40°	15'	9.31 "N	20°	25'	1.89 "E
Z. 23	40°	15'	8.80 "N	20°	25'	2.22 "E

**RREGULLORE****PËR ADMINISTRIMIN E QENDRËS
HISTORIKE TË FSHATIT BËNJË DHE
ZONËS SË MBROJTUR PËRRETH**

Neni 1

Qëllimi dhe objektivat

1. Kjo rregullore përcakton detyrimet dhe mënyrat për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të fshatit Bënjë-Novoselë, Njësia Administrative Petran, Bashkia Përmet.

2. Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje janë:

a) Administrimi i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të fshatit Bënjë, sipas hartës së zonifikimit, që i bashkëngjitet kësaj rregulloreje, si pjesë integrale e saj;

b) Mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike të fshatit Bënjë.

3. Kjo rregullore përcakton mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore të qytetit të Përmetit për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Qendrës Historike të fshatit Bënjë.

Neni 2

Struktura e hapësirës urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje e fshatit Bënjë, për vlerat e saj historiko-kulturore dhe si pjesë e trashëgimisë kulturore, i nënshtrohet ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në fuqi.

2. Hapësira urbane në mbrojtje e fshatit Bënjë, përbëhet nga:

a) Qendra Historike e fshatit Bënjë;

b) Zona e mbrojtur.

3. Kufijtë e Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur paraqiten në hartën e zonifikimit të fshatit Bënjë, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

4. Plani i përgjithshëm vendor i qytetit të Përmetit duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes të Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur.

Neni 3

Qendra Historike dhe kufijtë e saj

1. Qendra Historike e fshatit Bënjë është pjesa me vlera urbanistiko-arkitektonike e fshatit dhe hapësira që mbart vlera të rëndësishme historike, që dokumenton rrugën e zhvillimit historik të fshatit drejt krijimit të një qendre të banuar dhe tiparet urbanistiko-arkitekturore që u formuan gjatë historisë së tij. Pjesa dërrmuese e fshatit ruan rrjetin rrugor karakteristik dhe ndërtime të vjetra, me vlera arkitektonike e konstruktive. Këto ndërtime janë të lidhura me mjedisin tradicional, i cili është pjesë e Qendrës Historike. Brenda kësaj Qendre përfshihet edhe kisha e Shën Mërisë, objekt monument kulture i kategorisë së parë.

2. Hapësira urbane me vlera historiko-kulturore e fshatit Bënjë formohet, nga:

a) Qendra Historike, e cila përfshin zonën e banimit të fshatit;

b) Zona e mbrojtur, e cila pozicionohet rreth Qendrës Historike dhe përfshin pjesën më të madhe në juglindje të Qendrës Historike.

3. Kufijtë e Qendrës Historike të fshatit Bënjë paraqiten me koordinata gjeografike në tabelën 1, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 4

Ndërhyrjet e lejuara në Qendrën Historike

1. Në Qendrën Historike nuk lejohen ndërtimet e reja.

2. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekturore të Qendrës Historike, brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

a) Ndërhyrje sistematike konservuese, restauruese në objektet e Qendrës Historike. Këto ndërhyrje mbështeten në kriteret për konservim dhe restaurim, në aktet normative kombëtare dhe ndërkombëtare të fushës, të zbatueshme edhe në vendin tonë;

b) Në raste fatkeqësish natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.;



c) Rrjeti rrugor tradicional dhe sheshet ruhen në kompozim dhe teknikë ndërtimi;

ç) Lejohen ndërhyrje në përmirësimin e infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, projekti i të cilave miratohet në KKR.

Neni 5

Zona e mbrojtur dhe kufijtë e saj

1. Zona e mbrojtur shtrihet përreth Qendrës Historike. Ajo mbron vlerat e Qendrës Historike dhe krijon një kalim të butë drejt pjesës tjetër të fshatit. Në pjesën jug-lindore ajo përfshin edhe një pjesë të rrugës hyrëse për në fshat dhe, nisur edhe nga konfiguracioni i terrenit, shërben për të mbrojtur më mirë peizazhin arkitektonik.

2. Kufijtë e Zonës së mbrojtur të Qendrës Historike të fshatit Bënjë paraqiten me koordinata gjeografike në tabelën 2, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 6

Ndërhyrjet e lejuara në Zonën e mbrojtur

1. Ndërhyrjet në Zonën e mbrojtur janë, si më poshtë vijon:

a) Ruhet rrjeti rrugor në kompozimin dhe me formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik. Në këtë zonë kryhen restaurime, përshtatje, rikonstruksione apo edhe ndërtime të reja për të rritur vlerat e saj, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të Qendrës Historike;

b) Nuk lejohen ndryshimet në rrjetin rrugor ekzistues. Ato ruhen në formulimin kompozicional, si pjesë organike e këtyre zonave;

c) Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhen t'i përshtatet karakterit arkitektonik të ndërtimeve të Qendrës Historike, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të tyre, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.;

ç) Lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve nuk duhet të kalojë 3 katet;

d) Specifikimet e detajuara teknike për përshtatjet, rikonstruksionet apo edhe ndërtimet e reja përcaktohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, në bashkëpunim me zyrat përkatëse të organeve të planifikimit të territorit;

dh) Rrjetit rrugor tradicional dhe sheshet ruhen në kompozim dhe teknikë ndërtimore.

e) Lejohen ndërhyrje në përmirësimin e infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, projekti i të cilave miratohet në KKR.

Neni 7

Klasifikimi i objekteve brenda Qendrës Historike

1. Brenda Qendrës Historike të fshatit Bënjë përcaktohen ndërtimet që shpallen monumente kulture, të cilat, sipas vlerave të tyre arkitektonike, ndahen në dy kategori: monumente të kategorisë së parë dhe monumente të kategorisë së dytë. Kjo ndarje sipas vlerave pasqyrohet në shkallën e ruajtjes së tyre si dhe në mënyrat dhe shkallën e ndërhyrjes konservuese dhe restauruese.

2. Monumentet e kategorisë së parë janë shembujt me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitektonike, që pasqyrojnë zhvillimin tipologjik dhe karakteristikat arkitektoniko-teknike të ndërtimeve të Qendrës Historike.

3. Monumentet e kategorisë së dytë janë ndërtime me vlera arkitektonike dhe historiko-kulturore, kryesisht si formuese të ansambleve urbanistiko-arkitekturore, që marrin pjesë në formulimin kompozicional të fshatit, por dhe ruajnë vlera arkitekturore në vetvete.

Neni 8

Monumentet e kategorisë së parë

1. Monumentet e kategorisë së parë janë ndërtimet me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitektonike. Monumentet e kategorisë së parë, me shkallë të mirë autenticiteti, ruhen në përbërësit kompozicionalë, arkitekturorë, në teknikën ndërtimore dhe të materialeve të ndërtimit. Oborri, muret rrethuese, porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse janë pjesë organike e monumentit dhe, si të tilla, i nënshtrohen të njëjtit trajtim.

2. Monumentet e kategorisë së parë ruhen në Qendrës Historike dhe në Zonën e mbrojtur.

3. Në monumentet e kategorisë së parë kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme dhe të brendshme si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale nuk mund të ndryshohet, me përjashtim të vendosjes së njëjës higjieno-sanitare, kur është e domosdoshme dhe nuk cenon vlerat për të cilat është vënë në mbrojtje.



4. Ndërhyrjet në monumentet e kategorisë së parë ruajnë kompozimin dhe teknikat origjinale, si në brendësi, ashtu edhe në pamjet e jashtme. Në rastet kur një pjesë e monumentit ka pësuar dëmtime, transformime ose mungon, mund të ndërmerren ndërhyrje plotësuese, sipas dokumentacionit të plotë grafik dhe fotografik.

Neni 9

Monumente të kategorisë dytë

1. Monumentet e kategorisë së dytë janë ndërtimet me vlera arkitektonike e historiko-kulturore, kryesisht si bashkëformuese ansamblesh urbanistiko-arkitekture, por edhe si vepra të veçanta.

2. Monumentet e kategorisë së dytë ruhen në volumet e tyre dhe në trajtimin arkitekturor të pamjes së jashtme, duke përfshirë materialet dhe teknikat tradicionale. Kur brenda këtyre monumenteve, sidomos në objektet e banimit, ruhen ambiente karakteristike, si gdhendje në dru, punime në allçi, dekorime pikturale ose mobilime arkitektonike me vlerë, këto ruhen në vendin ku janë.

3. Në brendësi të monumenteve të kategorisë së dytë lejohen ndryshime të strukturës kompozicionale dhe përdorimi i teknikave bashkëkohore, pa cenuar formulimin e pamjes së jashtme.

Neni 10

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Qendrën Historike dhe në monumente të veçanta

1. Projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës bëhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjekte të licencuara për këtë qëllim.

2. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR).

3. Zbatimi i punimeve të mësipërme kryhet nga DRKK-të ose nga subjekte të licencuara për restaurim, nën mbikëqyrjen e supervisorit dhe kolaudatorit, caktuar nga IMK-ja dhe DRKK-Gjirokastrë. Për monumentet e kulturës pronë private, pjesa e shpenzimeve që i takon pronarit dhe mënyra e shlyerjes së tyre bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Studimet dhe projektet për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhinierik hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare (DRKK-Gjirokastrë), në bashkëpunim me Bashkinë Përmet ose nga persona të licencuar në fushën e restaurimeve dhe në kategoritë përkatëse të punimeve. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

Neni 11

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Zonën e mbrojtur

1. Studimet për rehabilitimin e imazhit të Zonës së mbrojtur hartohen nga IMK-ja, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare (DRKK-Gjirokastrë), në bashkëpunim me Bashkinë Përmet, ose nga subjekte të licencuara në fushën e restaurimeve, sipas rregullores së miratuar. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

2. Projektet e rikonstruksionit të ndërtesave në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme, për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

3. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet prej subjekteve ndërtimore që janë të licencuara për këtë kategori.

4. Projektet për ndërtimet e reja në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

5. Projektet e rikonstruksionit të rrugëve, shesheve dhe infrastrukturës së tyre hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë përkatëse në fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin



Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

Neni 12

Shfrytëzimi i monumenteve

1. Monumentet e kulturës janë pjesë e jetës urbane të fshatit. Ato shfrytëzohen, sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar apo edhe për funksione të tjera, me kusht që këto funksione të mos cenojnë vlerat, për të cilat monumenti është vënë në mbrojtje.

2. Mënyrat e përdorimit përcaktohen në ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar. Shfrytëzimi i monumenteve të kulturës për funksione të ndryshme, prej atyre për të cilat janë ndërtuar, bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR).

Neni 13

Mbrojtja e monumenteve

1. Organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e monumenteve të ngritura në hapësirat e juridiksionit të tyre.

2. Plani rregullues i Bashkisë Përmet, detyruesisht, merr parasysh vlerat e Qendrës Historike.

Neni 14

Komiteti mbikëqyrës i Qendrës Historike

1. Për të ndihmuar dhe mbikëqyrur veprimtarinë dhe vlerësimin e Qendrës Historike dhe monumenteve të kulturës në fshatin Bënjë, pranë Bashkisë së qytetit Përmet ngrihet Komiteti Mbikëqyrës i Qendrës Historike.

2. Ky komitet është një strukturë këshillimore dhe jovendimmarrëse, i cili përbëhet nga 5 anëtarë. Kryetari i këtij komiteti caktohet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore të bashkisë dhe ka në

përbërjen e tij përfaqësues të institucioneve shtetërore të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, të shoqatës së arkitektëve të qytetit, të përfaqësuesve të pronarëve dhe përdoruesve të ndërtimeve të Qendrës Historike si dhe të organizmave joshetërorë, që ushtrojnë veprimtari për mbrojtjen e vlerave historiko-kulturore të bashkisë.

3. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtij komiteti përcaktohet në rregulloren e funksionimit të brendshëm, që miratohet me 50%+1 të votave të të gjithë anëtarëve.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe, për pasojë, nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave, ato zgjidhen prej Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe Ministrisë së Kulturës.

Neni 16

Kundërvajtjet administrative

Shkelja e kësaj rregulloreje ngarkon me përgjegjësi sipas dispozitave të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 17

Dispozita të fundit

1. Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozimin e ministrit të Kulturës dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Kjo rregullore shoqërohet me hartën përkatëse të Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të fshatit Bënjë.

3. Brenda 6 muajve, nga botimi në Fletoren Zyrtare të kësaj rregulloreje, Instituti i Monumenteve të Kulturës i paraqet ministrit përgjegjës për trashëgiminë listën e monumenteve të kulturës për shqyrtim e miratim.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 148 lekë